



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 4854 / Prot.  
2

Tiranë më, 08 / 03 / 2022

**Drejtuar:** Të gjitha Departamenteve në DPD

Të gjitha Degëve Doganore

Drejtorive në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm

**Lënda:** Përcillet për njohje e zbatim Manuali udhëzues “Për formalitetet doganore të hyrjes së mallrave në Republikën e Shqipërisë”

Në kuadër të Projektit të Binjakëzimit AL 17 IPA FI 02 20 "Mbështetje për Administratën Doganore Shqiptare në lidhje me zbatimin e Kodit Doganor të BE-së dhe rritjen e kapaciteteve operationale në fushën e mallrave të falsifikuara" janë draftuar një sërë manualesh të natyrës udhëzuese të Bashkimit Evropian, një ndër të cilët është edhe Manuali udhëzues “Për formalitetet doganore të hyrjes së mallrave në Republikën e Shqipërisë”.

Ky manual udhëzues mbështetet në “Guidance document on Customs Formalities on Entry and Import into the European Union” të dhjetorit 2018 të Bashkimit Europian, Ref. Ares (2018)6352314 - 11/12/2018. Ai është i një natyre shpjeguese, që ju vjen në ndihmë strukturave doganore për të lehtësuar zbatimin korrekt dhe uniform të legjislacionit doganor në praktikë. Kodi Doganor dhe Dispozitat e Zbatuese të tij kanë përparësi mbi përmbajtjen e këtij manuali.

Bashkëlidhur po Ju dërgojmë për njohje dhe zbatim Manualin udhëzues “Për formalitetet doganore të hyrjes së mallrave në Republikën e Shqipërisë”, të miratuar përmes urdhrit nr. 06, datë 08, 03, 2022 të DPD.

Manualin do ta gjeni të publikuar në faqen web të doganës <https://dogana.gov.al/c/171/198/legjislacioni-doganor>, Manuale udhëzues.

Duke Ju falënderuar,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Genti Gazheli**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 4854/1 Prot.

Tiranë, më 08.03.2022

**URDHËR**

Nr. 06 - datë 08.03.22 -

Mbështetur në nenet 6, 23, 27, 74, 84, 109 deri 114, 119 deri 122, 124, 130 deri 132, 134 deri 139, 155 deri 159, 179, 185, 207, 286, të ligjit nr. 102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 1, 159, 233 deri 245, 249 deri 251, 256, 304, 311, 316, 328 deri 329, 432 deri 437, 554, 546, dhe nenin 737, të VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit Nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe pikën 1(b)(i), të Pjesës VIII/1, të VKM Nr. 921, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për personelin e administratës doganore”, të ndryshuar;

Me synim zbatimin korrekt dhe trajtimin uniform të dispozitave për hyrjen e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Manualit udhëzues “Për formalitetet doganore të hyrjes së mallrave në Republikën e Shqipërisë” sipas përmbajtjes bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij Manuali udhëzues, ngarkohen të gjitha strukturat doganore.

Ky Manual udhëzues hyn në fuqi me datë 08/03/2022.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Genti Gazheli**



<sup>1</sup> Ky manual udhëzues mbështetet në “Guidance document on Customs Formalities on Entry and Import into the European Union” të dhjetorit 2018 të Bashkimit Europian, Ref. Ares (2018)6352314 - 11/12/2018. Ky manual nuk përbën një akt ligjërish të detyrueshëm dhe është i një natyre shpjeguese. Kodi Doganor dhe Dispozitat e Zbatuese të tij kanë përparësi mbi përmbajtjen e këtij manuali dhe duhet të konsultohen gjithmonë. Qëllimi i tij është të sigurojë një mjet për të lehtësuar zbatimin korrekt dhe uniform të legjisllacionit doganor në praktikë.

**MANUAL UDHËZUES**  
**“PËR FORMALITETET DOGANORE TË HYRJES SË MALLRAVE NË**  
**REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

**Tabela e përmbajtjes**

SHKURTIME .....	3
<b>PJESA A</b> .....	<b>4</b>
<b>HYRJA</b> .....	<b>4</b>
<b>PJESA B</b> .....	<b>5</b>
<b>DEKLARATA PËRMBLEDHËSE E HYRJES</b> .....	<b>5</b>
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SITUATËS AKTUALE.....	5
VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM: ELEMENTET E REJA.....	5
<b>SHPJEGIME MBI KËRKESAT E ZBATUESHME GJATË PERIUDHËS TRANSITORE</b>	<b>6</b>
1. Depozitimi i DPH.....	6
2. Kërkesat e të dhënave.....	7
3. Zyra doganore kompetente për depozitimin e DPH.....	7-8
4. Heqja dorë nga detyrimi për të depozituar DPH.....	8-10
5. Afatet kohore për të depozituar DPH.....	11
6. Depozitimi i DPH nga një palë e tretë.....	12
7. Depozitim i dyfishtë i paqëllimshëm .....	12
8. Përgjegjësitë e deklaruesit .....	12
9. Ndryshimi i DPH .....	13
<b>PJESA C</b> .....	<b>14</b>
<b>FORMALITETET NË HYRJE NDRYSHE NGA DEPOZITIMI I DPH</b> .....	<b>14</b>
SITUATA AKTUALE QE ZBATOHET .....	14
SITUATA E ZBATUESHME PAS IMPLEMENTIMIT TE SISTEMEVE .....	14
1. Njoftimi i mbërritjes.....	14
2. Njoftimi ndryshimit të vendit të mbërritjes.....	14-15
3. Paraqitja e mallrave në doganë .....	15
<b>PJESA Ç</b> .....	<b>16</b>
<b>MAGAZINIMI I PËRKOHSHËM</b> .....	<b>16</b>
SITUATA AKTUALE.....	16
MASAT TRANSITORE .....	16
1. Deklarata e magazinimit të përkohshëm .....	16-18

2.	Vendi i magazinimit të përkohshëm .....	18-22
3.	Magazinimi i mallrave shqiptare dhe jo-shqiptare.....	22
4.	Lëvizja e mallrave jo-shqiptare ndërmjet ambienteve të magazinimit të përkohshëm .....	22-27
<b>PJESA D .....</b>		<b>28</b>
<b>DEKLARATA DOGANORE.....</b>		<b>28</b>
PAMJA NË TË ARDHMEN (Elemente të reja): .....		28
1.	Depozitimi i deklaratës doganore .....	28
2.	Përdorimi i deklaratave në letër .....	28
3.	Deklarimi nëpërmjet veprimeve të tjera.....	29
4.	Deklarimi me gojë.....	29
5.	Kuptimi i "Zyrës doganore kufitare".....	29
6.	Ndryshimi i deklaratës.....	30-31
7.	Pavlefshmëria e deklaratës doganore .....	31
8.	Deklarata doganore e depozituar përpara paraqitjes së mallrave.....	32
9.	Deklarata doganore për mallrat në dërgesa postare .....	32

## SHKURTIME

<b>OEA</b>	Operator Ekonomik i Autorizuar
<b>ATA Carnet</b>	Lejimi i Përkohshëm me Carnet ATA
<b>DPH</b>	Deklarata Përmbledhëse e Hyrjes
<b>EORI</b>	Identifikimi dhe Regjistrimi i Operatorit Ekonomik
<b>RSh</b>	Republika e Shqipërisë
<b>ShNAC</b>	Shoqata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
<b>Asycuda World</b>	Sistemi i Kontrollit të Importit aktualisht në përdorim
<b>SKI</b>	Sistemi i ri i Kontrollit të Importit sipas planit të punës të ministrit përgjegjës për financat
<b>IMO</b>	Organizata Ndërkombëtare e Detit
<b>MRN</b>	Numri Referencë
<b>NCTS</b>	Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Transitit
<b>NCTS-TIR</b>	Sistemi i Ri i Kompjuterizuar i Transitit/Transport Ndërkombëtar
<b>Sisteme IT</b>	Sisteme të Teknologjisë së Informacionit
<b>MP</b>	Magazininim i përkohshëm
<b>DMP</b>	Deklarata e Magazininimit të Përkohshëm
<b>KD</b>	Ligji Nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar
<b>DZKD</b>	VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për Dispozitat Zbatuese të ligjit Nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar
<b>UUP</b>	Unioni Universal i Postave
<b>Plani i punës së MFE</b>	Plani i punës së ministrit përgjegjës për financat për implementimin e sistemit të informatizuar të nevojshëm për të përmbushur detyrimet e KD, siç referohet në nenin 286, të KD

## **PJESA A**

### **HYRJE**

Qëllimi kryesor i këtij manuali është që të japë shpjegime lidhur me formalitetet doganore për mallrat që hyjnë në RSh. Gjithashtu të japë shpjegime lidhur me elementët e Kodit Doganor që do të zbatohen pas implementimit të sistemeve të nevojshme IT, që mundësojnë zbatimin e plotë të KD.

## **PJESA B**

### **DEKLARATA PËRMBLEDHËSE E HYRJES**

#### **VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I SITUATËS AKTUALE:**

Me përjashtim të paragrafit të parë të nenit 233, dhe pikave 1 dhe 2 të nenit 234 të DZKD, deri në datën e implementimit të sistemit përkatës sipas Planit të Punës të MFE, deklaratat përmbledhëse të hyrjes do të depozitohen nëpërmjet:

- manifestit në rastin e mjeteve lundruese, ajrore, hekurudhore;
- deklaratës transit, CMR në rastin e transportit rrugor, ose
- çdo forme tjetër të pranuar nga zyra doganore përkatëse.

*Implementimi i SKI është parashikuar në nenin 286 të KD, në DZKD dhe në Planin e punës së MFE.*

#### **VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM: ELEMENTET E REJA**

##### **Situata që zbatohet pas implementimit të sistemit informatik SKI:**

- Grupe të reja të dhënash (për të gjitha mënyrat e transportit), përfshirë një "grup minimal para-ngarkimit" në transportin ajror;
- Regjistrim i shumëfishtë, dmth. Depozitimi i DPH me anë të paraqitjes së grupeve të ndryshme të të dhënave nga i njëjti person ose nga persona të ndryshëm, është i zbatueshëm vetëm në mënyrën ajrore dhe detare të transportit (shih nenet 243, 244, 234, 245 dhe 248 të DZKD)
- Procese të reja të analizës së riskut që zbatohen sipas mënyrës së transportit (shih nenin 248 DZKD).
- Afate të reja për ngarkesat ajrore ku DPH duhet të depozitohet sa më shpejt të jetë e mundur maksimumi deri para se mallrat të ngarkohen në avionin në të cilin ato futen në territorin doganor të RSh. Kur para ngarkimit është dhënë vetëm grupi minimal i të dhënave, të dhënat e tjera duhet të dërgohen brenda afateve kohore të zbatueshme aktualisht (shih pikën 6 më poshtë).
- Ndryshime të rasteve të heqjes dorë nga detyrimi për të paraqitur një DPH (shih pikën 4 më poshtë).

## ***SHPJEGIM I KËRKESAVE QË ZBATOHEN GJATË PERIUDHËS TRANSITORE***

### **1. DEPOZITIMI I DPH**

#### ***1.1 Paraqitja e të dhënave (neni 119, pikat 1 - 6 të KD)***

Shih më sipër Pjesën B - DEKLARATA PËRMBLEDHËSE E HYRJES  
Vështrim i përgjithshëm i situatës aktuale (nenet 233 dhe 234 të DZKD)

#### ***1.2 Përdorimi i sistemeve informatike të portit ose sistemeve të ngjashme tregtare ose të transportit (neni 119, pika 7, e KD)***

Portet, aeroportet dhe mënyrat (nyjet) e tjera të transportit ose tregtare përdorin platforma elektronike që lidhin sisteme të shumfishta të operuara nga një shumëllojshmëri organizatash. Këto platforma shërbejnë si porta hyrëse për regjistrimin e deklaratave doganore.

DPH e depozituar duke përdorur platforma të tilla mund të pranohet me kusht që:

- autoritetet doganore ta miratojnë;
- të përmbushen kërkesat e zbatueshme të sistemit, dhe
- të depozitohet brenda afateve kohore të kërkuara.

#### ***1.3 E drejta e hyrjes në sistemin informatik të operatorit ekonomik***

Autoriteti doganor mund të pranojë depozitim të një njoftimi dhe hyrjen në të dhënat e DPH në sistemin informatik të operatorit ekonomik. Kjo është e mundur vetëm kur sistemi i operatorit ekonomik (neni 119 pika 8 e KD):

- ruan dhe përpunon të dhënat në një mënyrë të pajtueshme me kërkesat e zbatueshme, dhe
- lejon transferimin e informacionit në portet dhe aeroportet pasuese (shih pikën 3.1 më poshtë).

#### ***1.4 Depozitimi paraprak i deklaratës doganore ose një deklaratë për magazinim të përkohshëm***

Në rastet kur një deklaratë doganore ose një deklaratë e magazinimit të përkohshëm (DMP) depozitohet paraprakisht dhe brënda afatit kohor të përcaktuar dhe përmban të dhënat e DPH, mund të hiqet dorë nga depozitimi i DPH (neni 122 KD).



## **2. KËRKESAT E TË DHËNAVE**

### **2.1 Kërkesat e zbatueshme të të dhënave**

Shih më sipër Pjesën B - DEKLARATA PËRMBLEDHJE E HYRJES

Vështrim i përgjithshëm i situatës aktuale (nenet 233 dhe 234 të DZKD)

### **2.2 Kërkesa të përzgjedhura të të dhënave**

- **Numri identifikues dhe i regjistrimit të operatorit ekonomik**

Personi që depoziton DPH duhet të përfshijë numrin e tij të regjistrimit dhe identifikimit të operatorit ekonomik (EORI). Kur DPH depozitohet me një grup të plotë të të dhënave nga një person i ndryshëm nga transportuesi, duhet të sigurohet edhe EORI i transportuesit, p.sh. kur një agjent doganor po vepron në emër të transportuesit dhe paraqet një DPH.

- **Përshkrimi i mallrave**

## **3. ZYRA DOGANORE KOMPETENTE PËR DEPOZITIMIN E DPH**

### **3.1 Zyra doganore e parë e hyrjes**

Për mallrat e sjella në RSh nga një vend i tretë nga një anije ose një aeroplan që ndalon në më shumë se një port ose aeroport në territorin doganor të RSh, DPH duhet të depozitohet në zyrën e parë doganore të hyrjes. *(neni 119, pika 3 e KD)*

Nëse anija ose aeroplani ndalon në një vend të tretë, dhe ka destinacion një port ose aeroport në RSh, atëherë një DPH e re duhet të depozitohet në zyrën e parë doganore të hyrjes për të gjitha mallrat në bordin e mjeteve të transportit në përputhje me të gjitha rregullat dhe procedurat e DPH.

Nuk kërkohet DPH për anijet ose aeroplanët që lundrojnë ose fluturojnë midis dy porteve ose aeroporteve të RSh-së.

Kurdoherë që zyra doganore e parë e hyrjes identifikon një risk për mallrat e transportuara në anije ose aeroplan, ajo duhet të informojë mbi rezultatet e riskut zyrrat doganore përkatëse, në mënyrë që këto mallra të jenë subjekt i kontrollit doganor pas mbërritjes së tyre (lloji i riskut B) ose me shkarkimin e planifikuar (lloji i riskut C)

Zyra doganore e parë e hyrjes duhet të marrë masa të menjëhershme në rastet e rrethanave të jashtëzakonshme kur Mbetjet e Mallrave në Bord (Freight Remaining on Board FROB) mendohet se paraqesin kërcënim aq serioz për mbrojtjen dhe sigurinë e RSh-së sa që kërkohet ndërhyrje e menjëhershme.

Për trafikun me kontenier në det të hapur, kur mallrat nuk do të ngarkohen në anijen për transport në RSh duhet të sigurohet mesazhi përkatës nga personi që depoziton DPH, dhe kur është i ndryshëm edhe nga transportuesi, brenda afatit prej 24 orësh për përfundimin e vlerësimit të riskut, pas depozitimit të DPH. Sidoqoftë, në rast se informacioni për riskun merret pas nisjes së anijes, veprimi i menjëhershëm në mënyrë përjashtimore merr formën e kontrolleve në pikën e parë të hyrjes.

### **3.2 Depozitimi i DPH në një zyrë tjetër doganore**

Një nga mundësitë për të paraqitur DPH sipas KD është ta depozitosh atë në një zyrë doganore të ndryshme nga zyra doganore e parë e hyrjes.

Kjo mundësi mund të jetë e disponueshme vetëm nëse autoritetet doganore e lejojnë këtë. (*Neni 119, pika 3, paragrafi i dytë, i KD*)

Deri në implementimin e SKI kur DPH dërgohet në një zyrë doganore e ndryshme nga zyra doganore e parë e hyrjes, ajo zyrë do t'ja dërgojë të dhënat e kërkuara për depozitimin e DPH zyrës doganore të parë të hyrjes për vlerësimin e riskut që do të kryhet.

Në mënyrë që të përdoret mundësia për të paraqitur DPH në një zyrë doganore të ndryshme nga zyra doganore e parë e hyrjes, DPH e depozituar duhet të regjistrohet menjëherë dhe ti komunikohet ose ti bëhet e disponueshme zyrës doganore të parë të hyrjes. Pas regjistrimit të DPH duhet të lëshohet MRN.

Kur operatori ekonomik përdor këtë mundësi duhet të depozitohet DPH brenda një afati kohor të caktuar në zyrën ku është paraqitur DPH, edhe nëse ka një vonesë në transmetimin e datës në zyrën doganore të parë të hyrjes.

## **4. HEQJA DORË NGA DETYRIMI PËR TË DEPOZITUAR DPH**

(neni 119, pika 2, e KD dhe neni 235 i DZKD)

### **4.1 Vështrim i përgjithshëm**

Ekzistojnë dy raste të heqjes dorë nga detyrimi për të paraqitur DPH:

- për mallrat e transportuara me mjete transporti që kalojnë vetëm përmes ujërave territoriale ose hapësirës ajrore të territorit doganor të RSh pa ndaluar brenda këtij territori (*neni 119, pika 2, shkronja "a" të KD*), ose
- në raste të tjera që justifikohen siç duhet në varësi të llojit të mallrave ose trafikut, ose kur kërkohet nga marrëveshjet ndërkombëtare (*neni 119, pika 2, shkronja "b" të KD*).

Sipas KD, vlera nuk është më një kusht për heqjen dorë nga detyrimi për të paraqitur DPH për një kategori të caktuar mallrash pasi nuk mund të jetë kriter për vlerësimin e riskut të sigurisë dhe mbrojtjes.

Seksionet më poshtë kanë të bëjnë me llojet e zgjedhura të mallrave dhe shpjegojnë ndryshimet nga rregullat ekzistuese dhe periudhat kalimtare që zbatohen. Aty përmenden në mënyrë specifike artikujt e korrespondencës, dërgesat postare dhe mallrat që përfitojnë nga mundësia për të përdorur deklaratën me gojë ose deklaratën me ndonjë akt tjetër. Në fund jepet shpjegimi për përjashtimet e tjera që mbeten të vlefshme, por kushtet në të cilat ato janë dhënë janë ndryshuar.

#### 4.2 Artikujt e korrespondencës (neni 1, pika 37 dhe neni 235, pika 1, shkronja “c” të DZKD)

Artikujt e korrespondencës përcaktohen si letra, kartolina, letra braile dhe materiale të shtypura që nuk kanë detyrime importi ose eksporti. Si të tillë, ata përjashtohen nga detyrimi për të paraqitur DPH pavarësisht nga natyra e ndërmjetësit, p.sh. operatori postar ose shërbim i shpejtë, i cili i dërgon ato te marrësi.

#### 4.3 Dërgesat postare (neni 1, pika 35 dhe neni 235, pikat 2 - 3, të DZKD)

Përjashtimet e përgjithshme për artikujt që lëvizin në përputhje me aktet e miratuara nga Bashkimi Postar Universal (UPU) janë hequr. Tabela më poshtë përcakton rregullat që zbatohen në dy faza të ndryshme deri në 31 Dhjetor 2023.

Deri në implementimin e SKI sipas Planit të Punës së MFE	Pas SKI dhe para datës 31.12.2023	Pas datës 31.12.2023
DPH nuk kërkohet	DPH kërkohet por mund të jenë të nevojshme përshtatjet e kësaj kërkesë, deri në 31.12.2023.	Zbatimi i heqjes dorë do të rishikohet.

Pas implementimit të ICS por para datës 31 Dhjetor 2023, analiza e riskut për mallrat në dërgesat postare që tejkalon 250 g bëhet me paraqitjen e mallrave, nëse janë të disponueshëm, bazuar në deklaratën e magazinimit të përkohshëm ose në deklaratën doganore të mallrave në fjalë (neni 249, pika 5 e DZKD).

Deri më 31 dhjetor 2023, ministria përgjegjëse për financat dhe DPD-ja do të shqyrtojnë situatën lidhur me mallrat në dërgesat postare sipas këtij paragrafi, me qëllim marrjen e masave të nevojshme, duke marrë parasysh përdorimin e mjeteve elektronike nga operatorët postarë që mbulojnë lëvizjen e mallrave. (neni 235, pika 2 e DZKD).

#### 4.4 Heqja dorë për mallrat që kanë vlerë nën 22 Euro (neni 235, pika 4 e DZKD)

Heqja dorë do të vazhdojë të zbatohet deri në implementimin e SKI sipas Planit të Punës së MFE.

#### **4.5 Heqja dorë për mallrat e deklaruarra nëpërmjet akteve të tjera ose deklaratave me gojë (neni 235, pika 1 e DZKD)**

Ky përjashtim zbatohet për dy lloje mallrash. Këto janë artikujt e korrespondencës (shih pikën 5.2) ose mallrat e mëposhtëm me kusht që ato të mos transportohen sipas një kontrate transporti:

- produktet e marra nga fermerët e RSh në pronat e vendosura në një vend të tretë dhe produktet e peshkimit, kultivimit të peshkut dhe aktivitetëve të gjuetisë, të cilat përfitojnë nga heqja e detyrimit sipas neneve 432 deri 435 të DZKD;
- farat, plehrat dhe produktet për trajtimin e të mbjellave të tokës të importuara nga prodhuesit bujqësorë në vendet e treta për përdorim në pronat fqinje me ato vende, të cilët përfitojnë nga përjashtimi nga detyrimet sipas neneve 436 dhe 437 të DZKD;
- mjetet e transportit që përfitojnë nga heqja e detyrimit të importit si mallra të kthyera në përputhje me nenin 185 KD;
- paletat, kontejnerët dhe mjetet e transportit dhe pjesët rezervë, aksesoret dhe pajisjet për Këto paleta, kontejnerë dhe mjete transporti kur ato mbulohen nga një deklaratë me gojë;
- instrumentet muzikorë të lëvizshëm të ri-importuar nga udhëtarët dhe duke përfituar nga heqja e detyrimit të importit si mall i rikthyer në përputhje me nenin 185 KD.

#### **4.6 Ndryshimet në përjashtimet e mbetura**

- Carnetet ATA ose CPD

Mallrat që lëvizin nën carnet ATA ose CPD vazhdojnë të jenë të përjashtuara, por vetëm nëse nuk i nënshtrohen një kontrate transporti:

- Mallrat e furnizuar për konsum, shitje ose përdorim të anijeve ose aeroplanëve në bord  
Përjashtimi për mallrat e furnizuar në bordin e anijes ose avionëve shtrihet në të gjitha mjetet detare dhe ajrore të transportit, pavarësisht nëse ata ndalojnë jashtë territorit doganor të RSh-së ose jo.

- Furnizimet

Një përjashtim i ri është shtuar për anijet dhe mallrat e transportuara në to që hyjnë në ujërat territoriale të RSh me qëllimin e vetëm për të marrë furnizime në bord pa lidhje me ndonjë nga ambientet portuale.

## 5. AFATET KOHORE PËR DEPOZITIMIN E DPH (nenet 236 – 242 DZKD)

Afatet e mëposhtme kohore janë të zbatueshme gjatë gjithë periudhës kalimtare.

TRANSPORTI DETAR	AFATI
1. Ngarkesa në konteiner përveç transportit të shkurtër në det	24 orë përpara ngarkimit në anijen me të cilën do të hyjnë në territorin doganor të RSh
2. Ngarkesa rifuxho ose të ndara përveç transportit të shkurtër në det	4 orë përpara arrijtes së anijes në portin e parë të hyrjes në territorin doganor të RSh
3. Në rastin e mallrave që vijnë nga: - Groenlanda, - Ishujt Faroe - Islanda - Portet e detit Baltik, detit të Veriut, detit të Zi dhe detit Mesdhe, - Të gjitha portet e Marokut	2 orë përpara mbërritjes së anijes në pikën e parë të hyrjes në territorin doganor të RSh
TRANSPORTI AJROR	AFATI
1. Kohëzgjatja më pak së 4 orë	Koha aktuale e nisjes
2. Kohëzgjatja 4 orë ose më shumë	4 orë përpara mbërritjes së avionit në aeroportin e parë në territorin doganor të RSh
TRANSPORTI HEKURUDHOR	AFATI
1. Kur udhëtimi me tren nga stacioni i fundit i në një vend të tretë është më pak se 2 orë nga zyra doganore e parë e hyrjes	1 orë përpara se mallrat të mbërrijnë në vendin për të cilin zyra doganore e parë e hyrjes është kompetente
2. Në të gjitha rastet e tjera	2 orë përpara mbërritjes së mallrave në vendin për të cilin zyra doganore e parë e hyrjes është kompetente

Për transportin *rrugor* afati është 1 orë para mbërritjes së mallit në vendin për të cilin zyra doganore e parë e hyrjes është kompetente.

Për rrugët *ujore të brendshme* afati është 2 orë para mbërritjes së mallrave në vendin për të cilin zyra doganore e parë e hyrjes është kompetente.

Për transportin e *kombinuar*, afati kohor i zbatueshëm është ai që është i vlefshëm për mjetet aktive të transportit që hyjnë në territorin doganor të RSh.

## 6. DEPOZITIMI I DPH NGA NJË PALË E TRETË

(paragrafët e fundit të neneve 243 – 245 DZKD nuk zbatohen aktualisht)

## 7. DEPOZITIM I DYFISHTË I PAQËLLIMSHËM

### Pamje për të ardhmen

Shembuj:

- një DPH paraqitet nga një agjensi transporti mallrash dhe më pas nga transportuesi;
- një DPH depozitohet nga importuesi dhe më pas nga transportuesi ose agjencia e transportit të mallrave; ose
- një deklaratë doganore që përmban të dhënat e DPH depozitohet nga importuesi ose, në rast transiti, deklaruesi, dhe më pas DPH depozitohet nga agjencia e transportit ose transportuesi i mallrave.

Për sistemet informatike të cilat mund të trajtojnë vetëm një DPH për ngarkesë, rekomandohet që të dhënat e DPH të deklaruar më parë të mos merren parasysh. Sidoqoftë, DPH e paraqitur nga transportuesi ka përparësi. Kjo vlen edhe në rastet kur paraqitet përpara deklaratës së personit tjetër. Informacioni nga të dy DPH mund të përdoret për qëllime të analizës së riskut.

## 8. PËRGJEGJËSITË E DEKLARUESIT *(neni 23, i KD)*

Ashtu si me të gjitha deklaratat dhe njoftimet, deklaruesi duhet të mbajë përgjegjësi vetëm për saktësinë dhe tërësinë e të dhënave në kohën e depozitimit të DPH bazuar në informacionin që i është vënë në dispozicion. Në qoftë se ai ka arsye të besojë se të dhënat e ofruara nuk janë të sakta, ai mund të bazojë depozitimin e DPH në të dhëna që i janë dhënë nga palët e tij kontraktuese. Nga ana tjetër, personat që iniciojnë dhe lidhin kontraktë me p.sh. një konsolidues, një transportues mallrash ose një agjenci transporti për transportin e një ngarkese në territorin doganor të RSh, duhet t'i sigurojë informacion të plotë dhe të saktë për dërgesën agjensisë së transportit, transportuesit të mallrave ose konsoliduesit.

Kur i siguron të dhënat e kërkuara, deklaruesi nuk duhet të deklarojë pajisje për fiksimin e ngarkesave si rripa, kllapa, pjesë sigururie të ngarkesave etj., pasi këto objekte konsiderohen të jenë pjesë e paketimit dhe kështu pjesë e mallrave të deklaruar.

Nëse deklaruesi zbulon se një ose më shumë të dhëna të DPH janë deklaruar gabimisht ose janë ndryshuar, deklaruesi mund të kërkojë një ndryshim në DPH. Për më tepër, deklaruesi duhet të informojë autoritetin doganor nëse merr informacion se një person që inicion dërgesa që do të transportohen në territorin doganor të RSh jep sistematikisht informacion të pasaktë për dërgesat.

## **9. NDRYSHIMI I DPH (neni 121, i KD)**

Me qëllim sigurimin sa më të plotë dhe të saktë të DPH për vlerësimin e duhur të riskut, ndryshimet duhet të lejohen në të gjitha rastet që nuk përmenden në paragrafin e dytë të pikës 1, të nenit 121 të KD.

Vetëm pala që paraqet të dhënat e DPH mund ti ndryshojë ato të dhëna. Nëse deklaruesi merr dijeni se të dhënat e paraqitura fillimisht nuk janë më të sakta, ai duhet të kërkojë një ndryshim në DPH.

Në parim, nuk ka asnjë kufizim të parashikuar në legjislacion në lidhje me elementet e të dhënave që mund të jenë subjekt i ndryshimeve. Sidoqoftë, në praktikë, në rast se ndryshon deklaruesi dhe është e nevojshme një ndryshim në DPH do të ishte më praktikë të anulohet DPH origjinale dhe të paraqitet një e re në vend të saj.

Ndryshimet në DPH nuk pezullojnë ose rinovojnë afatet për paraqitjen e DPH.

Kur bëhet një ndryshim, analiza e riskut duhet të kryhet përsëri për të përshtatur të dhënat e ndryshuara. Kjo do të kishte një ndikim në çlirimin e mallrave vetëm kur ndryshimi bëhet pak para mbërritjes dhe autoriteteve doganore u duhet kohë shtesë për të kryer një analizë të duhur të riskut.

Nëse është bërë ndryshimi në DPH dhe është kryer analiza e riskut në lidhje me ndryshimin, risku i identifikuar dhe të dhënat e DPH në fjalë duhet të dërgohen tek autoritetet doganore kompetente në portin ose aeroportin pasues.

## **PJESA C**

### **FORMALITETET NË HYRJE NDRYSHË NGA DEPOZITIMI I DPH**

#### **SITUATA AKTUALE QË ZBATOHEM**

Mekanizmat aktualë për njoftimet e mbërritjes dhe të paraqitjes si dhe për depozitimin e deklaratës së magazinimit të përkohshëm mbeten të mundura përmes mjeteve të ndryshme nga ato elektronike.

#### **SITUATA E ZBATUESHME PAS IMPLEMENTIMIT TË SISTEMEVE INFORMATIKE**

Pas përfundimit të periudhave përkatëse kalimtare, siç mund të jetë rasti, transmetimi elektronik i të dhënave bëhet i detyrueshëm dhe zbatohen kërkesat e reja të dhe të harmonizuara të të dhënave. *(Neni 286, i KD)*

#### **1. NJOFTIMI I MBËRRITJES *(neni 124, i KD)***

Njoftimi i mbërritjes është mesazhi që i dërgohet zyrës doganore të parë të hyrjes për ta njoftuar atë se anija ose avioni ka mbërritur.

Njoftimi i Mbërritjes mund të marrë formën e informacionit të disponueshëm nga një anije detare ose një avion, në mënyrë të posaçme manifesti i mbërritjes.

Njoftimi i Mbërritjes duhet të përmbajë të dhënat e nevojshme për identifikimin e DPH të paraqitura më parë. Në rast të transportit të kombinuar, të dhënat e tilla mund të sigurohen nga operatori i mjetit aktiv të transportit që hyn në territorin doganor të RSh me anë të komunikimit sipas zgjedhjes së tij.

Njoftimi i Mbërritjes sigurohet nga:

- MRN për të gjitha dërgesat në mjetin/et e transportit së bashku me mënyrën e transportit në kufi, kodin e zyrës së parë doganore të deklaruar të hyrjes, kodin e deklaruar të zyrës së parë të mbërritjes dhe kodin e zyrës aktuale të parë të mbërritjes, ose
- të ashtuquajturat elemente të të dhënave "Kyç të Hyrjes", d.m.th. mënyra e transportit në kufi, identifikimi i mjeteve të transportit që kalojnë kufirin, p.sh. në numrin IMO të anijes të trafikut detar ose ajror, ose numrin e fluturimit IATA, datën e së pritshme të mbërritjes në zyrën doganore të parë të deklaruar të hyrjes, kodin për zyrën e parë të deklaruar të mbërritjes dhe kodin e zyrës aktuale të parë të mbërritjes.

#### **2. NJOFTIMI I DEVIJIMIT *(neni 251 DZKD)***

Kur një anije detare ose një avion që hyn në territorin doganor të RSh devijon dhe pritet të mbërrijë së pari në një zyrë doganore të vendosur në RSh, e cila nuk është shënuar në deklaratën përmbledhëse të hyrjes si vend i itinerarit, operatori i mjetit të transportit do të informojë zyrën doganore të treguar në deklaratën përmbledhëse të hyrjes për ndryshimin e zyrës doganore të e parë



të hyrjes për shkak të devijimit.

Nënparagrafi i parë nuk zbatohet kur mallrat janë futur në territorin doganor të RSh nën një regjim transiti në përputhje me nenin 132 të Kodit.

Zyra doganore e treguar në deklaratën përmbledhëse të hyrjes si zyrë doganore e hyrjes, menjëherë pasi të jetë informuar në përputhje me paragrafin 1, njofton zyrën doganore e cila sipas këtij informacioni është zyra doganore e re e hyrjes për shkak të devijimit. Ajo ja bën të disponueshme të dhënat përkatëse të deklaratës përmbledhëse të hyrjes dhe rezultatet e analizës së rrishtit zyrës doganore të re të hyrjes.

Asnjë njoftim devijimi nuk kërkohet në rast të një operacioni transiti.

Për mënyrat e tjera të transportit që mbërrin në një zyrë doganore të parë të hyrjes të ndryshme nga zyra doganore e parë të hyrjes e deklaruar në DPH, një DPH e re duhet të depozitohet në zyrën e hyrjes së parë në vend të një njoftimi devijimi.

### **3. PARAQITJA E MALLRAVE NË DOGANË (neni 130, i KD)**

Mallrat duhet të paraqiten në doganë me mbërritjen e tyre në territorin doganor të RSh dhe të bëhen të disponueshme për kontrollet doganore (pika 1, e nenit 130, të KD).

Për transportin **detar dhe ajror**, paraqitja e mallrave nga transportuesi në zyrën e caktuar doganore ose në ndonjë vend tjetër të caktuar ose të miratuar nga autoritetet doganore mund të bëhet njëherazi për të gjitha mallrat që do të shkarkohen nga anija ose avioni pra nuk do të kërkohet që ato të paraqiten në mënyrë individuale.

Për **mënyrat e tjera të transportit** - paraqitja e mallrave bëhet pas mbërritjes në zyrën e caktuar doganore ose në ndonjë vend tjetër të caktuar ose të miratuar nga autoritetet doganore.

Duhet të lejohen kushte të veçanta, përfshirë heqjen dorë nga detyrimi për të paraqitur mallra në doganë (pika 6, e nenit 130, të KD), me kusht që kontrollet dhe mbikëqyrja doganore të mund të kryhen siç duhet, në rastet e:

- mallrave të transportuara brenda zonave kufitare;
- mallrave të transportuara në tubacione dhe kablllo;
- artikujve të korrespondencës ose mallrave të tjerë me rëndësi të papërfillshme ekonomike si letra, kartolina dhe materiale të shtypura dhe ekuivalentet e tyre elektronike të mbajtura në media të tjera;
- mallrave të transportuara nga udhëtarët.

Për qëllimin e njoftimit të paraqitjes mund të shërbejnë edhe mënyra të tjera njoftimi. Për shembull, në "Manifestin e Mbërritjes" ka një referencë për DPH e transportuesit e cila duhet të pranohet si "Njoftimi i paraqitjes".

## **PJESA Ç**

### **MAGAZINIMI I PËRKOHSHËM**

Magazinimi i përkohshëm i referohet një situatë ligjore që zbatohet për mallrat jo-shqiptare që ruhen nën mbikëqyrje doganore. Kjo situatë fillon nga koha e paraqitjes së mallrave në doganë dhe mund të zgjasë jo më shumë se 90 ditë. Me paraqitjen e mallrave në doganë duhet të depozitohet një deklaratë e magazinimit të përkohshëm (DPM). Shkelja e këtij detyrimi mund të shkaktojë lindjen e një borxhi doganor për mospërbushje. (neni 6, pika 17 e KD)

#### **SITUATA AKTUALE**

- afati për magazinimin e përkohshëm shtrihet në 90 ditë pa mundësi zgjatje të mëtejshme;
- dhënia e një garancie bëhet e detyrueshme për autorizimet për të operuar ambiente të magazinimit të përkohshëm që janë të reja, përfshirë ato që jepen pas një rivlerësimi;
- mund të bëhet lëvizja e mallrave ndërmjet ambjenteve të magazinave të përkohshme pa i deklaruar ato për një regjim tjetër doganor kur ta lejojë sistemi elektronik përkatës.

#### **MASAT TRANSITORE**

Masat kalimtare zbatohen deri në implementimin e sistemit për njoftimin e mbërritjes, njoftimin e paraqitjes si dhe të sistemit të magazinimit të përkohshëm dhe përfshijnë:

- depozitimin e DMP (*shih seksionin 1*);
- MRN (*shih seksionin 1.3*);
- kërkesat e të dhënave (*shih seksionin 1.3*);
- aplikimet dhe autorizimet (*shih seksionin 2.1*).

### **1. DEKLARATA E MAGAZINIMIT TË PËRKOHSHËM**

#### **1.1. Depozitimi**

Deklarata e magazinimit të përkohshëm depozitohet në momentin e paraqitjes së mallrave në doganë.

Depozitimi i DMP mund të bëhet me mjete të tjera përveç metodave elektronike. Nëse DMP bëhet në mënyrë elektronike do të regjistrohet me MRN.

DMP mund të paraqitet nga një prej personave të përmendur më poshtë (pikat 1 dhe 3 të nenit 130, dhe pika 3, e neni 135, të KD):

- personi që sjell mallrat në territorin doganor të RSh;
- personi në emër të të cilit ose për llogari të të cilit vepron personi që sjell mallrat në RSh;
- personi që merr përsipër përgjegjësinë për transportin e mallrave pasi ato hyjnë në territorin doganor të RSh;
- çdo person që i vendos menjëherë mallrat nën një regjim doganor;
- mbajtësi i një autorizimi për funksionimin e ambjenteve të magazinimit ose çdo person që kryen një aktivitet në një zonë të lirë.

Forma e depozitimit të DMP:

- një paraqitje e të dhënave të DMP;
- një referencë në DPH e ndjekur nga plotesimi i të dhënave që mungojnë në DMP, siç është vendndodhja e saktë e mallrave në MP (kjo do të zbatohet kur sistemi DPH të jetë funksional) (shih më poshtë);
- manifesti i mallrave ose një dokument tjetër tregtar i paraqitur para mbërritjes mund të përdoret si DMP me kusht që të përmbajë të dhënat e kërkuara të DMP dhe të vihet në dispozicion të autoriteteve doganore. Elementet e të dhënave të përfshira në këtë dokument, për shembull të dhënat që kanë të bëjnë me vendndodhjen e mallrave duhet të jenë të mjaftueshme për të identifikuar mbajtësin e autorizimit për magazinim të përkohshëm me të cilin mund të bëhet kontakti nga autoritetet doganore për të përcaktuar vendndodhjen e saktë të mallrave (neni 135, pika 5 e KD);
- autoritetet doganore mund të pranojnë që sistemet informatike tregtare, portuale ose të transportit të përdoren për të depozituar një DMP me kusht që ato të përmbajnë të dhënat e nevojshme për një deklaratë të tillë. Elementet e të dhënave të përfshira në këtë dokument, për shembull të dhënat që kanë të bëjnë me vendndodhjen e mallrave duhet të jenë të mjaftueshme për të identifikuar mbajtësin e autorizimit për magazinim të përkohshëm me të cilin mund të bëhet kontakti nga autoritetet doganore për të përcaktuar vendndodhjen e saktë të mallrave. (Neni 135, pika 6 e KD)

Kur DMP ofron të dhënat e kërkuara dhe janë depozituar brenda afateve përkatëse kohore dhe në përputhje me çdo kusht që kërkohet (pika 8 e nenit 135, të KD), mund të përdoret gjithashtu për:

- një njoftim të mbërritjes;
- paraqitjen e mallrave në doganë.

## **1.2. Heqja dorë nga detyrimi për të paraqitur një DMP**

Detyrimi për të paraqitur DMP mund të hiqet në rastet e mëposhtme (pika 9, e nenit 135, të KD):

- një deklaratë doganore është depozituar para se mallrat të paraqiten në doganë;
- më së voni në kohën e paraqitjes së mallrave në doganë përcaktohet se mallrat kanë fituar statusin e mallraveshqiptare.

## **1.3. Kërkesat e të dhënave**

Kërkesat aktuale të të dhënave për DMP-në mbeten të zbatueshme gjatë periudhës kalimtare. Pas implementimit të sistemeve informatike përkatëse do të bëhet i zbatueshëm grupi i të dhënave të harmonizuara të DMP siç parashikohet në Aneksin B, të Shtojcës A, të DZKD.

Në veçanti, DMP duhet të përmbajë gjithmonë një referencë të DPH kur ajo paraqitet për të njëjtat mallra dhe kërkohet paraqitja e DPH. Megjithatë, *detyrimi për të dhënë një referencë në DPH nuk kërkohet në situatat e mëposhtme (pika 4 e nenit 135, të KD):*

- detyrimi për të paraqitur DPH nuk zbatohet në përputhje me nenin 235 DZKD,
- mallrat kanë qenë tashmë në magazinim të përkohshëm, p.sh. kur ato janë paraqitur në doganë në rastin e ngarkimit në zyrën e parë doganore të hyrjes dhe më pas është bërë shkarkimi dhe magazinimi nën mbikëqyrjen e zyrës doganore kompetente; ky skenar mund të jetë i zbatueshëm në rast të ndalesave të fluturimit; ose
- mallrat janë vendosur nën një regjim doganor dhe nuk janë larguar nga territori doganor i RSh (psh, transiti).

#### **1.4 Ndryshimet e DMP (neni 136, pika 1, e KD)**

Deklaruesi, me kërkesë, do të lejohet të ndryshojë një ose më shumë të dhëna të deklaratës së magazinimit të përkohshëm pasi të jetë depozituar. Ndryshimi nuk do ta bëjë deklaratën të zbatueshme për mallra të tjera nga ato që mbulonte fillimisht.

Asnjë ndryshim nuk është i mundur pas ndonjë nga sa rastet si vijon:

- a) autoritetet doganore kanë informuar personin që ka paraqitur deklaratën se synojnë të kontrollojnë mallrat;
- b) autoritetet doganore kanë vërtetuar se të dhënat e deklaratës janë të pasakta.

Nëse DMP që përmban të paktën të dhënat e një DPH depozitohet në përputhje me pikën 2, të nenit 122, të KD, pa anashkaluar nenin 136 KD, DMP mund të ndryshohet edhe pas njoftimit të mbërritjes kur e lejon sistemi informatik.

## **2. VENDI I MAGAZINIMIT TË PËRKOSSHËM**

Mallrat mund të vendosen në magazinim të përkohshëm në tre kategori vendesh:

- ambiente të magazinimit të përkohshëm;
- vendet e miratuara nga autoritetet doganore;
- vendet e caktuara nga autoritetet doganore.

### **2.1 Ambienti i magazinimit të përkohshëm**

#### **Situata aktuale:**

Aplikimi dhe autorizimi – i bazuar në letër

Në “e-albania” është planifikuar një zgjidhje elektronike për vendime të tilla.

*Aplikimi dhe autorizimi (neni 138, i KD)*

Deri ne implementimin e sistemit informatik do të përdoren aplikimet dhe autorizimet në letër. Kërkohe autorizim për operimin e një ambienti MP. Ambienti i MP duhet të përdoret ekskluzivisht nga mbajtësi i autorizimit. Kjo nuk përjashton faktin që që aktivitete të caktuara të kryhen nga palë të treta nën përgjegjësinë e mbajtësit të autorizimit.

*Shembuj:*

Një operator i terminalit të ngarkesave në një aeroport aplikon për një autorizim për të përdorur një ambient MP në ambiente të veçanta.

Një operator terminali në një port detar aplikon për një autorizim për të përdorur një ambient MP me ambiente të veçanta.

Autorizimi për magazinimin e mallrave shqiptare në ambientet e magazinimit të përkohshëm duhet të jepet vetëm kur mund të bëhet një dallim i qartë midis mallrave shqiptare dhe atyre jo-shqiptare në rast të mallrave identike, sepse ndarja e kontabilitetit nuk parashikohet në magazinimin e përkohshëm. Ndarja e kontabilitetit parashikohet vetëm për magazinimin doganor (*shih nenin 554 të DZKD*).

*Garancia (pika 2, e nenit 84, të KD)*

Sigurimi i garancisë për ambientet e magazinimit të përkohshëm është i detyrueshëm. Sidoqoftë, bazuar në aplikim, operatorët ekonomikë mund të autorizohen të përdorin një garanci globale, ose garanci globale me një shumë të reduktuar ose heqje dorë.

*Regjistrimet*

Në rast të një ndryshimi në DMP, mbajtësi i autorizimit do të sigurojë që të dhënat e regjistrit janë përditësuar në përputhje me rrethanat (*neni 138, pika 2, e KD*).

## **2.2. Vende të tjera të përcaktuara ose të miratuara nga autoritetet doganore për magazinim të përkohshëm**

- **Vendet e miratuara nga autoritetet doganore** (*neni 137, pika 1 e KD, neni 250 i DZKD*).

Mbi baza aplikimi, autoritetet doganore mund të miratojnë ambiente të tjera përveç ambienteve të MP që do të përdoren për MP. Në mungesë të kërkesave specifike të të dhënave për këtë aplikim, autoritetet doganore duhet të përdorin sipas gjyqimit të tyre kërkesat më të rëndësishme të të dhënave të cilat, megjithatë, duhet të jenë të mjaftueshme për të garantuar zbatimin e dispozitave përkatëse ligjore. Miratimi mund të jepet mbi baza ad-hoc, ose për një periudhë të caktuar kohe.

Kjo mundësi mund të përdoret kur mallrat duhet të vendosen nën një regjim doganor ose të rieksporthen për 1 ditë pas paraqitjes së tyre në doganë, përveçse kur autoritetet doganore kërkojnë që mallrat të kontrollohen në përputhje me pikën 2, të nenit 131, të KD. (*neni 137, pika 1 e KD, neni 250, pika 2, e DZKD*)

Përveç kësaj, duhet të plotësohen kushtet e mëposhtme (*pika 2, e nenit 138, të KD*):

- në mungesë të një garancie globale dhe nëse vendi nuk është caktuar nga dogana, sigurohet një garanci individuale;

- personi që magazinon mallrat duhet të jetë i vendosur në RSh.;
- personi që magazinon mallrat duhet të demonstrojë një kryerje të duhur të operacionit.

*Shembuj:*

Mallrat mbërrijnë në rrugë tokësore në ambientet e një pritësi të autorizuar (sipas kuptimit të shkronjës “b”, të pikës 4, të nenit 207, të KD), i cili aplikon për një autorizim për një vend të autorizuar për të mbajtur këto mallra nën MP në ambientet e tij. Në këtë rast, të dhënat e deklaratës së transitit përdoren si deklaratë e magazinimit të përkohshëm.

Lënda drusore arrin nga një vend i tretë në kufirin tokësor dhe duhet të matet para se të depozitohet deklarata doganore për çlirim për qarkullim të lirë. Gjatë kohës së matjes, mallrat janë në magazinim të përkohshëm në një vend të autorizuar.

Autorizimi për përdorimin e një vendi të miratuar nga autoritetet doganore për MP, dhe autorizimi për pritësin e autorizuar kanë secili bazën e tyre ligjore.

▪ **Vendet e caktuara nga autoritetet doganore**

Vendet e caktuara nga autoritetet doganore janë *vendet e vendosura si të tilla në diskrecionin e autoriteteve doganore*. Qëllimi për caktimin e vendeve të tilla është që të sigurohet kontroll dhe mbikëqyrje efektive dhe efikase doganore, veçanërisht për rastet kur, për shkak të natyrës së mallrave ose natyrës së mjeteve teknike të përdorura për kontrollin dhe mbikëqyrjen doganore, mallrat nuk mund të kontrollohen menjëherë në zyrën doganore. Në ndryshim nga vendet e miratuara për t'u përdorur për MP, për vendet e caktuara nuk kërkohet leje nga autoritetet doganore.

Në rast se mallrat mbahen nën MP në një magazinë që është e autorizuar si një magazinë doganore dhe e cila është caktuar nga autoritetet doganore për qëllimet e MP, nuk duhet të kërkohet garanci për MP.

Rastet kur përdoren vendet e caktuara nga autoritetet doganore mbulojnë, por nuk kufizohen në:

- Rastet kur, në varësi të volumit të trafikut të dërgesave, autoritetet doganore mund ta drejtojnë një trafik të tillë në vendet e caktuara në mënyrë që të trajtohet i ndarë nga trafiku tjetër, p.sh. të ndarë nga bagazhi ose trafiku i përgjithshëm i ngarkesave;

*Shembuj*

Zyrat doganore ku vëllimi i mallit është i vogël;

Vende të dedikuara në sallat e pasagjerëve në rast se dërgesat / mallrat vijnë si pjesë e bagazhit të pashoqëruar;

Kapanonet e mallrave në rast të dërgesave të transportuara si mallra.

- Mallrat paraqiten në zyrën doganore kompetente dhe në të njëjtën kohë depozitohet një deklaratë MP. Autoritetet doganore vendosin që mallrat duhet të kontrollohen fizikisht, por për shkak të natyrës së mallrave, kontrollet fizike në këtë zyrë nuk janë të mundura. Zyrat doganore e drejton lëvizjen drejt vendeve të përshtatshme.

*Shembuj*

Paraqitja në doganë e ushqimeve të ngrira ose mallrave të rrezikshme.

- Raste të tjera

*Shembuj*

Autoritetet Doganore përdorin një skaner të lëvizshëm. Çdo vend ku mallrat skanohen nga kjo pajisje është një vend i përcaktuar nga autoritetet doganore.

Përmbledhje e karakteristikave kryesore të vendeve 'të miratuara' dhe 'të caktuara':

Lënda	Ambienti MP	Vendi i Miratuar (për MP)	Vendi i caktuar	Shënime
<b>Fillimi</b>	Kërkesa nga OE	Kërkesë/Aplikim nga OE	Vendimi nga autoriteti doganor kompetent	
<b>Autorizimi</b>	Po	Po	Jo	
<b>Garancia</b>	Po	Po	Jo	
<b>Afati magazinimit</b>	deri 90 ditë	deri ditën tjetër	deri 90 ditë	
<b>Veprimi pasues</b>	Vendosja nën regjim ose ri- eksport	Vendosja nën regjim ose ri-eksport	Vendosja nën regjim ose ri- eksport	
<b>Detyrimi për regjistrimin e të dhënave në regjistër</b>	Po	Jo	Jo	

<b>Deklarata për magazinim të përkohshëm (deklarata e transimit mund të përdoret si DMP)</b>	Po	Po	Po
--	----	----	----

### **3. MAGAZINIMI I MALLRAVE SHQIPTARE DHE JO-SHQIPTARE (Neni 138, pika 6 ,e KD)**

Magazinimi i kombinuar i mallrave të shqiptare dhe jo-shqiptare në një ambient i cili është i autorizuar të përdoret si një magazinë e përkohshme, është e mundur vetëm aty ku mallrat shqiptare mund të identifikohen. Ky identifikim nuk është i mundur, për shembull, kur sheqeri jo-shqiptar dhe sheqeri shqiptar janë mbajtur në një sillos sepse kjo do të kërkonte ndarje kontabël e cila lejohet vetëm për magazinimin doganor.

### **4. LËVIZJA E MALLRAVE JO-SHQIPTARE MIDIS AMBIENTEVE TË MAGAZINIMIT TË PËRKOHSHËM**

#### **4.1 Rregulla të përgjithshme (Neni 138 (5) KD)**

Neni 138, pika 5, shkronja “a” e KD e lejon lëvizjen e mallrave ndërmjet hapësirave të magazinimit të përkohshëm nën përgjegjësinë e autoritetit doganor.

Neni 138, pika 5, shkronjat “b” dhe “c” të KD, neni 257 i DZKD dhe neni 256 DZKD përcakton në mënyrë shteruese kërkesat për lejimin e lëvizjes së mallrave ndërmjet ambienteve të përkohshme të vendosura nën juridiksionin e Degëve të ndryshme Doganore.

Autorizimi për funksionimin e objektit të magazinimit të përkohshëm duhet të përcaktojë kushtet në të cilat mund të ndodhin lëvizje të tilla. Nuk kërkohet autorizim i veçantë për lëvizjen.

Në rast se ka një autorizim ekzistues për përdorimin e një ambjenti magazinimi të përkohshëm dhe autoritetet doganore miratojnë mundësinë për të lëvizur mallra midis ambienteve të magazinimit të përkohshëm, autorizimi ekzistues i MP duhet të ndryshohet për të përfshirë miratimin.

Në rastet kur parashikohet lëvizja e mallrave në magazinim të përkohshëm ndërmjet ambienteve të magazinimit të vendosura në më shumë se një zyrë doganore, zyra doganore kompetente për



ambjentin e magazinimit të përkohshëm nga i cili do të zhvendosen mallrat duhet të konsultohet me zyren doganore përkatëse të ambjentit tjetër në mënyrë që të sigurojë përmbushjen e kushteve para se të autorizojë një lëvizje të tillë. Autorizimi për përdorimin e ambjenteve të magazinimit të përkohshëm duhet të përmbajë një referencë në vendimin e marrë në përputhje me këtë konsultim dhe datën kur ai iu njoftua kërkuarit. Nëse autoritetet doganore bien dakord, nuk do të jetë i nevojshëm lëshimi një autorizimi të ri por bëhet ndryshim i autorizimit ekzistues.

## 4.2. Raste

4.2.1. Autoritetet doganore mund të autorizojnë mbajtësin e autorizimit të MP për të lëvizur mallra jo-shqiptare në magazinim të përkohshëm nga një prej ambjenteve të tij të magazinimit të përkohshëm në një ambient tjetër të magazinimit të përkohshëm, i cili gjithashtu operohet nga ai, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: (një mbajtës autorizimi që operon në dy ambjente)

- Lëvizja nuk duhet të rrisë rrezikun për mashtrim;
- Lëvizja zhvillohet nën përgjegjësinë e një zyre doganore;

*(shih nenin 138, pika 5, shkronja "a" e KD)*

4.2.2. Autoritetet doganore gjithashtu mund të autorizojnë mbajtësin e autorizimit të MP për të lëvizur mallra jo-shqiptare në magazinim të përkohshëm nga ambjenti i tij i magazinimit të përkohshëm në një ambient tjetër të magazinimit të përkohshëm, që është nën juridiksionin e të njëjtës zyre doganore, por që operohet nga një person tjetër, me kusht që të gjitha nga kushtet e mëposhtme janë përmbushur: *(dy autorizime, dy mbajtës që mbulohehen nga një degë doganore)*

- Lëvizja nuk duhet të rrisë rrezikun për mashtrim;
- Lëvizja kryhet nën përgjegjësinë e një zyre doganore.

*(shih nenet 138, pika 5, shkronja "a" e KD dhe 256, pika 4 e DZKD)*

4.2.3 Autoritetet doganore mund të autorizojnë gjithashtu mbajtësin e autorizimit të MP për të lëvizur mallra jo-shqiptare në magazinim të përkohshëm nga mjedisi i tij i magazinimit të përkohshëm në një ambient tjetër magazinimi të përkohshëm, i cili gjithashtu operohet nga ai nën të njëjtin autorizim të MP dhe i cili ndodhet nën kompetencën e një zyre tjetër doganore, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: *(2 ambjente magazinimi dy zyra doganore të ndryshme, një operator)*

- Lëvizja nuk duhet të rrisë rrezikun për mashtrim;
- Mbajtësi i autorizimit të MP është OEA për thjeshtime doganore (OEAD).

*(shih nenet 138, pika 5, shkronja "b" e KD dhe 256, pikat 1 dhe 2, të DZKD)*

Një autorizim i tillë kërkon konsultim paraprak me zyrën tjetër doganore.

4.2.4 Autoritetet doganore mund të autorizojnë gjithashtu mbajtësin e autorizimit të MP për të lëvizur mallra jo-shqiptare në magazinim të përkohshëm nga ambjenti i tij i magazinimit të përkohshëm në një ambjent tjetër të magazinimit të përkohshëm, i cili ndodhet në një zyrë tjetër doganore dhe që operohet nga një person tjetër me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme: *(dy mbajtës autorizimi, dy ambiente të ndryshme në dy zyra të ndryshme doganore)*

- Lëvizja nuk duhet të rrisë rrezikun për mashttrim;
- Mbajtësit e autorizimeve të MP janë OEA për thjeshtime doganore (OEAD).
- Lëvizja në mjediset e tjera të magazinimit të përkohshëm në një zyrë tjetër doganore duhet të jetë në përputhje me rregullat procedurale të përcaktuara në nenin 256 DZKD.

*(shih nenin 138, pika 5, shkronja "c" e KD, nenet 256 dhe 257 DZKD)*

Një autorizim i tillë kërkon një konsultë paraprake mes zyrave doganore të përfshira.

Lëvizja e mallrave ndërmjet ambienteve të magazinimit të përkohshëm është e ndryshme nga lëvizja e mallrave nga një magazinë e përkohshme në një vend të caktuar nga autoritetet doganore.

#### *Shembull*

Lëvizja e kontejnerëve detarë nga mjedisi i magazinimit të përkohshëm në vendin e skanerit i cili është një vend që operohet nga autoriteti doganor nuk konsiderohet si lëvizje nën magazinim të përkohshëm në përputhje me nenin 138, pika 5 e KD.

### **4.3. Deklarata e magazinimit të përkohshëm**

Mallrat nën magazinim të përkohshëm që lëvizin midis ambienteve të magazinimit të përkohshëm mbulohen nga e njëjta deklaratë MP që paraqitet pranë zyrës doganore kompetente për ambjentin magazinimit të përkohshëm nga i cili transferohen mallrat.

Mbajtësi i autorizimit për përdorimin e ambjentit të magazinimit të përkohshëm në të cilin u transferuan mallrat duhet të bëjë një referencë të deklaratës së MP në regjistrat e tij.

### **4.4 Kohëzgjatja dhe afati**

Afati i magazinimit të përkohshëm fillon me paraqitjen e mallrave në zyrën doganore kompetente për vendin ku ndodhet ambjenti i magazinimit të përkohshëm dhe *nuk pezullohet nga lëvizja.*

Magazinimi i përkohshëm nuk fillon përsëri me mbërritjen e mallrave në ambjentin tjetër të

magazinimit të përkohshëm.

Një afat i ri i magazinimit të përkohshëm mundet të fillojë vetëm për ato mallra që kanë qënë vendosur nën një regjim transiti të jashtëm.

Pasojat në rast të mosrespektimit të afatit prej 90 ditësh për magazinim të përkohshëm janë si më poshtë:

Sipas nenit 139 të KD, afati i magazinimit për mallrat jo-shqiptare në magazinim të përkohshëm nuk mund të zgjatet.

Kur mallrat jo-shqiptare nuk vendosen nën një regjim doganor dhe as nuk rieksporthen brenda afatit 90-ditor, autoritetet doganore duhet të vendosin, në përputhje me nenin 74, pika 1, shkronja "a", të KD, për lindjen borxhit doganor për mos përmbushje të njërit prej detyrimeve të përcaktuara në legjisllacionin doganor në lidhje me magazinimin e përkohshëm të mallrave jo-shqiptare.

Borxhi doganor i lindur duhet të përcaktohet, të njoftohet, kontabilizohet dhe të rikuperohet nga debitori. Debitori përcaktohet në përputhje me nenin 74, pika 3, e KD.

Në mungesë të një baze ligjore, autoriteti doganor nuk mund të këmbëngulë për depozitim të një deklarate doganore për çlirim të lirë nga debitori. Sipas rastit, duhet të zbatohet neni 179, pika 1, shkronja "b" e KD (asgjësimi i mallrave).

Me qëllim që të shmanget lindja e borxhi doganor për shkak të mbarimit të afatit prej 90 ditësh, sugjerohet që mallrat të vendosen nën regjimin e magazinimit doganor nëse është e nevojshme që mallrat të ruhen për një periudhë më të gjatë se 90 ditë.

#### **4.5 Përgjegjësitë e mbajtësve të ambjenteve të magazinimit të përkohshëm**

Në rastet kur lëvizja kryhet siç përshkruhet në pikat 4.2.2 dhe 4.2.4 më lart, përgjegjësia e mbajtësit të ambjentit të parë magazinimit të përkohshëm përfundon kur mallrat futen në regjistrat e mbajtësit të ambjentit të dytë të magazinimit të përkohshëm ku mbërrijnë mallrat. Meqenëse kemi dy autorizime që lëshohen nga dy zyra të ndryshme doganore atëherë në autorizim bëhen përcaktimet sipas dakortësisë së zyrave të përfshira. Është e mundur që, si rezultat i konsultimit ndërmjet autoriteteve doganore kompetente, të parashikohet ndryshe në autorizim. (psh, kur lëvizja bëhet nga zyra doganore në Tiranë për në zyrën doganore në Durrës, në momentin që mallrat mbërrijnë në Durrës dhe mallrat regjistrohen përfundojnë përgjegjësitë e doganës Tiranë.

Kur mbajtësi i ambjentit të magazinimit të përkohshëm të mbërritjes ose nisjes nuk përmbush kërkesat për të njoftuar zyrën doganore kompetente ku është vendosur dhe mbajtësin e ambjentit tjetër të magazinimit të përkohshëm, mund të lind një borxh doganor për mospërmbushje në përputhje me nenin 74, të KD. Kur është rasti zbatohen sanksionet që parashikon Kodi Doganor. Përveç kësaj, mbajtësi i ambjentit të magazinimit të përkohshëm mund të humbasë statusin e tij të OEAD.


#### **4.6 Shkëmbimi i informacionit**

Ilustrimi i mëposhtëm tregon shkëmbimin e informacionit që kërkohet kur mallrat lëvizin midis magazinave të përkohshme siç përshkruhet në pikën 4.2.4 më lart:

Secili prej këtyre shkëmbimeve të informacionit duhet t'i referohet:

- MRN së DMP;

- datës në të cilën lëvizja e magazinimit të përkohshëm parashikohet të përfundojë.



#### 4.7 Përmbledhje

Mallrat fillimisht duhet të paraqiten në doganë sapo mbërrijnë në territorin doganor të RSh. Për të lëvizur mallrat jo-shqiptare midis ambienteve të magazinimit të përkohshëm, ekzistojnë dy zgjidhje të mundshme:

##### 1. Lëvizja e mallrave nën MP

Në katër rastet e përshkuara në pikën 4.2, mallrat jo-shqiptare në magazinim të përkohshëm mund të lëvizin/zhvendosen në një ambient tjetër të magazinimit të përkohshëm.

##### 2. Transiti i jashtëm i mallrave

Pas paraqitjes së tyre dhe brenda afatit 90-ditor, mallrat vendosen nën regjimin e transitit të jashtëm dhe zhvendosen në një ambient tjetër të magazinimit të përkohshëm ku transiti do të përfundojë dhe mallrat do të jenë përsëri në magazinim të përkohshëm (të ri).

Karakteristikat kryesore dhe ndryshimet e lëvizjes nën magazinimin e përkohshëm dhe procedura e transitit të jashtëm janë përmbledhur në tabelën më poshtë:

	<b>Magazinimi i përkohshëm (MP) Lëvizja</b>	<b>Regjimi i transitit të jashtëm</b>
<b>Deklarata</b>	Deklarata e magazinimit të përkohshëm (mund të marrë gjithashtu formën e një referimi në një DPH të plotësuar nga specifikat e DEMP ose (e-) manifestit ose ndonjë dokumenti tjetër transporti nëse përmban të dhënat e një DEMP.	Deklarata doganore për transit të jashtëm (regjim doganor). Sistemi informatik duhet të përdoret.
<b>Paraqitja e mallrave në doganë</b>	Paraqitja bëhet menjëherë. Neni 130 KD në vendin/portin e hyrjes.	Paraqitja duhet të bëhet menjëherë, neni 130 i KD në vendin / portin e hyrjes. Mallrat nga ai moment në MP (neni 134 KD). Mallrat në MP mund të vendosen më pas nën transit të jashtëm (brenda 90 ditësh sipas rregullave të MP).
<b>Autorizimi</b>	Po (neni 138 KD)	Jo (vetëm në rastin e thjeshtimeve).
<b>Garancitë</b>	Po, e detyrueshme (neni 138, pika 2, shkronja "c", e KD) megjithëse është e mundur reduktimi ose heqja dorë me autorizim.	Po, e detyrueshme, megjithëse është e mundur reduktimi ose heqja dorë me autorizim
<b>Si sigurohet mbikqyrja doganore?</b>	Asnjë kërkesë specifike përveç nenit 138, pika 5, e KD, i cili thotë se lëvizja është e mundur 'me kusht që lëvizja të mos rrisë rrezikun e mashtrimit' dhe operatori duhet të jetë një OEAD. Nëse përfshihet më shumë se një autoritet doganor duhet të respektohet neni 256 DZKD. Asnjë kërkesë specifike ligjore që mallrat të plumbosen. Sidoqoftë, duhet të mbahen regjistra që përmbajnë informacion në lidhje me lëvizjen e mallrave (shih nenin 138, pika 4, të KD).	Regjistrat nuk duhet të mbahen, por mallrat duhet të plumbosen; masa të tjera identifikuese dhe heqja dorë nga plumbosja janë të mundshme vetëm bazuar në autorizim. Monitorimi elektronik i mallrave në transit.
<b>Kërkesa OEA</b>	Po, nëse përfshihet më shumë se një zyrë doganore	Jo
<b>Afati 90 ditë</b>	Përfundimi i magazinimit të përkohshëm brenda 90 ditëve (i njëjti afat prej 90 ditësh pa marrë parasysh lëvizjen në ambientet e tjera të magazinimit të përkohshëm)	Përfundimi i magazinimit të përkohshëm brenda 90 ditëve duke vendosur mallrat nën regjimin e transitit të jashtëm. Me përfundimin e transitit të jashtëm, mallrat janë përsëri në magazinim të përkohshëm (afati i ri 90 ditë)

## **PJESA D**

### **DEKLARATA DOGANORE**

PAMJA NË TË ARDHMEN (Elemente të reja):

- Deklaratat standarde dhe të thjeshtuara mund të paraqiten gjithashtu duke futur të dhënat në regjistrat e deklaruesit;
- Deklaratat doganore, përveç deklaratave me gojë dhe deklaratave me ndonjë akt tjetër, duhet të depozitohen me mjete elektronike;
- Kufizimi i rasteve kur mund të përdoret një deklaratë e bazuar në letër (shih seksionin 1).
- Ndryshimi i rasteve kur mund të depozitohet një deklaratë me ndonjë akt tjetër (shih seksionin 2).
- Ndryshimi i rasteve kur mund të depozitohet një deklaratë me gojë (shih seksionin 3).
- Rregulla të reja për depozitimin e deklaratës doganore përpara paraqitjes së mallrave në doganë (shih seksionin 5).
- Deklaratë e re për dërgesat postare me të dhëna të reduktuara (shih seksionin 6)

**Elementet e reja do të zbatohen në datën e implementimit të sistemit të ri të importit.**

#### **1. DEPOZITIMI I DEKLARATËS DOGANORE**

Rregulli i përgjithshëm është që një deklaratë elektronike të depozitohet në vend të Dokumentit të Vetëm Administrativ.

Deri në implementimin e sistemeve përkatëse informatike mund të lejohet që deklarata doganore për clirim për qarkullim të lirë të depozitohet me mjete të ndryshme nga mjetet elektronike. Në këtë rast pezullohet zbatimi i kërkesave të të dhënave të Aneksit B të Shtojcës A, të DZKD. Në varësi të formës së mjeteve jo-elektronike të shkëmbimit të informacionit që përdoren, grupe të tjera të ndryshme të të dhënave do të zbatohen deri në vendosjen e sistemit përkatës informatik.

#### **2. PËRDORIMI I DEKLARATAVE NË LETËR**

Udhëtarët mund të paraqesin një deklaratë doganore në letër në lidhje me mallrat që transportojnë me vete.

### 3. DEKLARATA NËPËRMJET VEPRIMEVE TË TJERA

Nuk ka nevojë për deklaratë doganore por veprime të caktuara konsiderohen si deklaram doganor (neni 311, i DZKD)

Artikujt e korrespondencës do të konsiderohen se janë deklaruar për çlirim në qarkullim të lirë sapo hyjnë në territorin doganor të RSh, pavarësisht nga deklaruesi ose lloji i ndërmjetësuesit (shërbimi postar ose një shërbim postar i shpejtë) (neni 311, pika 2, e DZKD).

Në të njëjtat kushte, operatorët postarë që lëvizin mallrat sipas rregullave të UPU mund të paraqesin një deklaratë me ndonjë akt tjetër për mallrat që janë të përjashtuara nga detyrimet doganore me kusht që të paguhen taksat dhe detyrimet e tjera.

Deri në implementimin e sistemit të informatizuar të importit sipas Planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, mallrat, vlera e të cilave nuk kalon 22 euro konsiderohen të deklaruara për çlirim për qarkullim të lirë me paraqitjen e tyre në doganë, në përputhje me nenin 130, të Kodit, me kusht që të dhënat e kërkuara të jenë pranuar nga autoritetet doganore. (neni 311, pika 5, e DZKD).

### 4. DEKLARIMI ME GOJË

Deklarimi ME GOJË është i mundur për rastet (mallrat) e mëposhtme (neni 304, pika 1, të DZKD):

- mallra të natyrës jotregtare;
- mallra të një natyre tregtare të përfshira në bagazhet personale të udhëtarëve me kusht që ato të mos kalojnë vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1000 (një mijë) EUR ose 1000 kg në peshë neto;
- produktet e marra nga fermerët shqiptarë të vendosur jashtë territorit të RSh dhe produktet e peshkimit, kultivimit të peshkut dhe gjuetisë, aktivitete që përfitojnë nga përjashtimi i detyrimeve, sipas neneve 304, pika 1, shkronja “c” dhe 432 deri 435 të DZKD;
- farërat, plehrat dhe produktet për trajtimin e tokës dhe të mbjellave të importuara nga prodhuesit bujqësorë në vendet e treta për t'u përdorur në pronat fqinje me ato vende që përfitojnë nga përjashtimi i detyrimeve sipas nenit neneve 304, pika 1, shkronja “ç” dhe 436 deri 437 të DZKD.

### 5. KUPTIMI I "ZYRËS DOGANORE KUFITARE"

Për qëllime të zbatimit të nenit 155, pika 3, shkronja “c”, të KD funksionet e një “Zyre doganore kufitare mund ti jepen një zyre doganore brenda territorit.

## 6. NDRYSHIMI I DEKLARATES

Deklaruesi mund të kërkojë një ndryshim të të dhënave të caktuara në deklaratën doganore (neni 158 i KD).

Ndryshimi i deklaratës doganore bëhet në bazë të një vendimi nga autoritetet doganore kompetente. Ky është një vendim doganor që merret pas aplikimit të deklaruesit në përputhje me nenin 27, të KD.

Meqenëse ndryshimi i deklaratës doganore mund të bëhet vetëm me kërkesë të deklaruesit, aktualisht nuk ka asnjë bazë ligjore për ndryshime *ex officio*. Sidoqoftë, me qëllim që të sigurohet mbledhja saktë e detyrimeve doganore që janë të detyrueshme, autoritetet doganore mund të fillojnë veprimet e rikuperimit pa e ndryshuar deklaratën doganore.

Në rast se kjo kërkesë ka të bëjë me mallra që janë mbuluar fillimisht nga e njëjta deklaratë doganore, ajo duhet të pranohet përveç nëse:

- autoritetet doganore kompetente e kanë informuar deklaruesin se synojnë të kontrollojnë mallrat;
- autoritetet doganore kanë vërtetuar se deklarata doganore është e pasaktë; ose
- autoritetet doganore kanë çliruar mallrat.

Rastet janë shteruese.

Megjithatë është gjithashtu e mundur që kërkesa për një ndryshim të bëhet brenda tre vjetësh pas pranimit të deklaratës doganore.

Në përputhje me nenin 158, pika 3 e KD ndryshimi i një deklarate doganore është i mundur përmes një kërkesë të deklaruesit të depozituar brenda tre vjetësh nga pranimi i deklaratës me qëllim që të përmbushë detyrimet në lidhje me vendosjen e mallrave nën regjimin doganor në fjalë. Si parim i përgjithshëm, gjatë këtyre tre viteve, deklaruesi mund të kërkojë një ndryshim vetëm nëse nuk është kërkuar pavlefshmëria e deklaratës doganore.

### **Rimbursimi ose Falja** (*Titulli III, Kreu III, Seksioni 3, të KD*)

Ndryshimi i deklaratës doganore mund të çojë në një rimbursim ose falje të detyrimeve doganore. Ndryshimi i deklaratës doganore dhe rimbursimi ose falja e detyrimeve doganore janë veprime të veçanta dhe kanë baza ligjore të veçanta. Si pasojë, secila prej tyre nuk është parakusht për tjetrën. Prandaj, nuk ka një lidhje formale ligjore midis nenit 158, pika 3, e KD dhe procedurës së parashikuar në nenin 114, të KD.

### **Të drejta të tjera ligjore**

Autoritetet doganore duhet të lejojnë ndryshime në deklaratën doganore kur ka një ndryshim në situatën përkatëse ligjore që krijon të drejta ligjore.



#### *Shembuj*

1. Informacioni i detyrueshëm tarifor i dhënë më parë nga dogana bëhet i pavlefshëm ose ndryshon (është dhënë gabim) dhe, si rezultat, mallrat duhet të klasifikohen nën një nënkre tarifor që jep një tarifë më të ulët.
2. Në përputhje me ndryshimin në informacionin detyrues të origjinës, origjina e mallrave përcaktohet të jetë në një vend, produktet me origjinë të të cilit i nënshtrohen një regjimi më përfitues të taksës doganore.
3. Një certifikatë origjine anulohet dhe mallrat që janë deklaruar fillimisht duhet të riklasifikohen dhe detyrimet e paguara të rregullohen.

#### **Kufizime të mundshme**

Në parim, çdo e dhënë në deklaratën doganore mund të ndryshohet, për sa kohë që kërkesa për ndryshim ka të bëjë me mallrat që mbulohen që në fillim nga e njëjta deklaratë doganore.

Sidoqoftë, në praktikë mund të ketë raste, kur është e nevojshme të përjashtohet mundësia e ndryshimit. Një rast i tillë mund të jetë për shembull, nëse ndryshimi ka të bëjë me deklaruesin. Në një rast të tillë, do të ishte më praktike që të bëhet e pavlefshme deklarata doganore fillestare dhe të zëvendësohet me një deklaratë të re që tregon deklaruesin aktual.

#### **7. PAVLEFSHMËRIA E DEKLARATËS DOGANORE**

Pavlefshmëria e deklaratës doganore është një akt juridik i autoritetit doganor kompetent që merret në bazë të një aplikimi të arsyetuar nga deklaruesi dhe bazuar në një vendim doganor të marrë në bazë të nenit 27, të KD.

Vetëm në raste specifike të parashikuara në KD dhe në dispozitat zbatuese të tij deklarata doganore që është pranuar mund të bëhet e pavlefshme.

Ekzistojnë dy lloje të rasteve kur deklarata doganore që është pranuar mund të bëhet e pavlefshme:

- kur autoritetet doganore janë të bindur që mallrat do të vendosen menjëherë nën një regjim tjetër doganor, (*neni 159, pika 1, shkronja "a" dhe neni 329, pikat 1 – 3 të DZKD*) ose
- kur autoritetet doganore janë të bindur që për shkak të rrethanave të veçanta vendosja e mallrave nën këtë regjim nuk është më e justifikuar (*neni 159, pika 1, shkronja "b" dhe neni 329, pika 4 e DZKD*).

Në secilin nga këto raste, nëse autoritetet doganore e kanë informuar deklaruesin se kanë qëllim të kontrollojnë mallrat, fillimisht do të bëhet kontrolli e më pas do të bëhet pavlefshmëria e deklaratës doganore.

Kërkesa për pavlefshmëri të deklaratës doganore bazuar në nenin 329, pikat 1- 3 të DZKD, duhet të dorëzohet brenda 90 ditëve nga data e pranimit të deklaratës doganore.

Në rastin e nenit 329, pika 4, shkronja “ç”, e DZKD vetëm deklaratat doganore të pranuar gjatë periudhës së parashikuar në nenin 546, pika 2, e DZKD mund të jenë subjekt i pavlefshmërisë.

## **8. DEKLARATA DOGANORE E DEPOZITUAR PËRPARA PARAQITJES SË MALLRAVE**

Deklarata doganore mund të depozitohet dhe të dhënat e paraqitura mund të përpunohen para paraqitjes së mallrave në doganë. Sidoqoftë, deklarata doganore mund të pranohet vetëm kur mallrat paraqiten në doganë ose konsiderohen të paraqitura (*neni 156, 157 KD, neni 328 DZKD*).

Deri në datën e implementimit të sistemit të informatizuar për eksport/importin, sipas planit të punës së ministrit përgjegjës për financat, kur një deklaratë doganore është depozituar përpara paraqitjes së mallrave sipas nenit 156 të KD dhe nenit 328 të DZKD, autoritetet doganore mund të lejojnë përdorimin e mjeteve të ndryshme nga teknika elektronike të përpunimit të të dhënave, për depozitim të njoftimit të paraqitjes.

Një nga rastet kur mund të depozitohet deklarata doganore është rasti kur ajo depozitohet në vend të DPH (*neni 119, 122, pika 1, të KD*). Të dhënat e DPH kërkohen.

Në rast se deklarata doganore është depozituar përpara paraqitjes së mallrave (*neni 156 i KD*) dhe deklaruesi ka kërkuar një ndryshim në të dhënat e deklaratës atëherë do të zbatohen rregullat që zbatohen për amendimin dhe pavlefshmërinë e DPH (*neni 121, pika 1, e KD*).

Kur të dhënat që duhet t'i shërbenin qëllimit të DPH duhet të bëhen të pavlefshme, kjo duhet të bëhet në përputhje me rregullat e zbatueshme për DPH (*neni 121, pika 2, e KD*).

Kur deklarata doganore duhet të anulohet, kjo duhet të bëhet në përputhje me nenin 159, të KD.

## **9. DEKLARATA DOGANORE PËR MALLRAT NË DËRGESA POSTARE**

Për çlirim në qarkullim të lirë të mallrave të një natyre jotregtare për dërgesat postare përdoret deklarata e thjeshtuar, me kusht që të plotësohen kërkesat e mëposhtme: (*neni 316 i DZKD*)

- vlera e tyre nuk e kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 1000 EUR;
- nuk bëhet asnjë kërkesë për rimbursim ose falje në lidhje me to;
- ato nuk u nënshtrohen ndalimeve dhe kufizimeve; dhe
- operatori postar që sjell mallrat në territorin doganor të RSh vepron si përfaqësues doganor.

Kjo deklaratë është një deklaratë doganore me të dhëna të reduktuara, e cila përmban të njëjtat kërkesa për të dhënat si ato për deklarimin e thjeshtuar.

Përdorimi i saj është opsional për operatorët postarë.

Për mallrat tregtare duhet të depozitohet një deklaratë standarde.